

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKTA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Nesrin Lushta kryetare, Valdete Daka dhe Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini - Simnica, si procesmbajtëse, në çështjen penale të dënuarit Xh.K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK, duke vendosur sipas kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë të dënuarit, ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1298/2016 datë 28.3.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.878/2017 datë 24.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 6.3.2018, morri ketë :

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit Xh.K. ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1298/2016 datë 28.3.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.878/2017 datë 24.10.2017.

A r s y e t i m

Me aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.129/2016 datë 28.03.2017, i dënuari Xh.K., është shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK, dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale si dhe me dënim me gjobë në shumë prej 150 € i cili dënim po ashtu nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë nuk kryen vepër të re penale. I dënuari është obliguar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 €, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. E dëmtuara KEDS- distrikti në Prizren për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civilo-juridik.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PA1.nr.878/2017 datë 24.10.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të dënuarit, kurse aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari Xh.K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja ti kthehet gjykatës

së shkallës së parë në rivendosje apo aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe i dënuari të lirohet nga akuza.

Prokurori i Shteti me parashtrësën KMLP.II.nr.229/2017 datë 5.12.2017, ka propozuar që të refuzohet si e pabazë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e ushtruar nga i dënuari Xh.K..

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi :

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

I dënuari në kërkesë pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në faktin se edhe pse i dënuari e ka pranuar fajësinë, ky pranim i fajësisë nuk është i bazuar në provat që janë bashkangjitur aktakuzës . I dënuari pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë është kontradiktor dhe atë nga fakti se në arsyetim të këtij aktgjykimi konstatohet se gjendja faktike është vërtetuar nga pranimi i fajësisë, edhe pse nga provat nuk ka mundur të vërtetohet se kush e ka futur shiritin filmik në njehsorë të orës edhe pse pllombat kanë qenë të padëmtuara. Po ashtu, pretendon se edhe pse ka pranuar fajësinë i njëjti këtë e ka bërë duke mos i kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë dhe në mungesë të këshillimit me mbrojtës, sepse ai nuk është njoftuar se ka të drejt të angazhoj mbrojtës. Ndërsa Gjykata e Apelit, po ashtu, këto shkelje edhe pse i ka vërejtur nuk i ka përmirësuar. Të gjitha këto kanë bërë që në dëm të tij të shkelet ligji penal me vet faktin se është dënuar për një vepër penale të cilën nuk e ka kryer.

Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe nga shkresat e çështjes konstatoi se i dënuari në procesverbalin mbi shqyrtimin fillestarë të datës 28.3.2017, është udhëzuar në kuptim të nenit 246 të KPPK, se me atë rast ka deklaruar se mbrojtjen e tij do ta bëj vetë dhe se për avokat mbrojtës nuk ka nevojë. Më tutje në të njëjtin procesverbal qëndron konstatimi i gjykatës ku të dënuarit i është bërë njoftimi lidhur me pranimin e fajësisë dhe se në rast se i njëjti e pranon fajësinë kjo do ti merret si rrethanat lehtësuese me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit . Po ashtu i dënuari është njoftuar se nuk do të ketë procedurë të administrimit të provave dhe se aktgjykimi i marrë në bazë të pranimit të fajësisë nuk mund të ankimohet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. I dënuari vullnetarisht e ka pranuar fajësinë sipas pikave të aktakuzës që i është lexuar më parë dhe i njëjti ka qenë plotësisht i vetëdijshëm se për cilat veprime është duke pranuar fajësinë, pra ka qenë plotësisht i vetëdijshëm se sipas aktakuzës ai akuzohet se ka shfrytëzuar energjinë elektrike me njehsorë në të cilin në brendi për rreth qelqit nga ana e majtë ka të futur shirit filmik, pra është penguar puna e diskut, ashtu që energjia e shpenzuar elektrike nuk është regjistruar.

Të gjitha këto duke u bazuar në shkresat e çështjes vërtetojnë se i dënuari plotësisht ka qenë i njoftuar me të drejtat e tij dhe me pasojat e pranimit të fajësisë dhe se me të drejt gjykata e shkallës së parë ka pranuar këtë pranim të fajësisë i cili përveç që është marrë në mënyrë të vullnetshme është edhe i bazuar në provat të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës, çka me të drejtë e konstaton edhe Gjykata e Apelit në procedurën ankimore.

Duke u bazuar në këtë kjo Gjykatë gjen se aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe se nuk është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit.

Andaj, duke u bazuar në të gjitha këto dhe duke u bazuar në nenin 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
Pml.nr. 342/2017 datë 6 mars 2018

Procesmbajtëse,
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta